



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15923/20 datë:19.08.2020



Npi – 01/182 datë: 31.08.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi ankesën me numër: Nr.01-070/05-9498/20 datë:16.06.2020, të z.Adem Ramadani, (Kryetar i fshatit Raçak), i cili në emër të Kryesisë së fshatit Raçak, ka shprehur shqetësimet e banorëve të fshatit, lidhur me dhënien e pëlqimit nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, për operimin, minimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit natyror nga një Kompani e gurthyesve në vendin e quajtur “Rreze” në fshatin Raçak, me numër të parcelës P-72809071-00109-0, evidentuar në librat kadastral “Pasuri Shoqërore, Kombinati i Drurit – Sektori i Pyjeve”. Arsytet pse ne si banor të fshatit Raçak refuzojmë kategorikisht që të epet leje për të punuar një gurthyes i tillë janë të shumta por po i numërojmë disa më kryesore:

1. Afërsia e madhe me vendodhjen e Masakrës së Raçakut, (Kodra e Bebushit)
2. Dëmtimi i imazhit dhe bukurive natyrore në afërsi të Kompleksit të Masakrës së Raçakut,
3. Rreziku shumë i madh nga shterrja e burimeve natyrore të ujit për rreth fshatit,
4. Shkarkimi i Pluhurit e zhurmës për banorët si dhe për vizitorët e Kompleksit Memorial,
5. Shkaktimi i dridhjeve nga minimet, dëmtimet e mundshme të objekteve të banimit në fshat,
6. Dëmtimet e rrugëve lokale me Maune të ngarkesave të rënda, etj.

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pikat (c dhe f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008); dhe pasi analizoi ankesën e palës, Rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR HEDHJEN POSHTË TË ANKESËS Nr.01-070/05-9498/20 TË ADEM RAMADANIT NGA FSHATI RAÇAK

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 31.08.2020, unanimitisht aprovoi vendimin për hedhjen poshtë të ankesës me numër: Nr.01-070/05-9498/20 datë:16.06.2020, të z.Adem Ramadani, (Kryetar i fshatit Raçak) me arsyetimin se Kuvendi nuk është kompetent për të vendosur për këtë.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj